



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:080562

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05450513

Pml.nr.103/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit V. S, nga D., me vendbanim në lagjen F., p. B, hyrja ... kati ... në P., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën e mbrojtëses se të dënuarit për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PAKR.nr.630/2023 datë 22.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 12 mars 2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Aprovohet si e bazuar kërkesa e mbrojtëses se të dënuarit V. S. për mbrojtje të ligjshmërisë, kurse aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PAKR.nr.630/2023 i datës 22.11.2023, anulohet dhe çështja i kthehet gjykatës së njëjtës në rigjykim.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.81/2023 e datës 16.10.2023, të dënuarin V. S., për veprën penale blerja, posedimi,

shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK, e ka gjykuar me dënim me burgim, në kohëzgjatje prej ... muaj, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 30.03.2023 deri më datë 28.07.2023, i cili do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, dhe dënim me gjobë prej ..., si dhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i shqipton dënim me gjobë në shumën prej ... euro. Andaj, gjykata në aplikim të nenit 76 par.1 të KPRK-së, i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej ... muaj në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datë 30.03.2023 deri më datë 28.07.2023, si dhe dënim unik me gjobë në shumën prej ... euro, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.630/2023 e datës 22.11.2023, ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, përkritazi me vendimin për dënim ashtu që Gjykata e Apelit të dënuarit V. S., për veprat penale për të cilat është shpallur fajtor i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej ... muaj, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 30.03.2023 deri më datë 28.07.2023, ndërsa dënimin me gjobë në shumën prej ... euro merr si të vërtetuar. Në pjesët tjera duke vendosur përkritazi me ankesën e mbrojtësit të dënuarit, me aktgjykimin PA1.nr.1218/23 datë 15 nëntor 2023, e ka refuzuar atë si të pabazuar dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës ka ushtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mbrojtësi i të dënuarit V. S., avokatja Kosovare Kelmendi nga Prishtina, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 lidhur me nenin 390 të KPP-së e të cilat shkelje kanë ndikuar në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të rregullt, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë në tersi kërkesën dhe të anulojë aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së dytë në rivendosje.

Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me parashtresën me shkrim KMLP.II.nr.60/2024 e datës 26.02.2024, me propozim që kërkesa e mbrojtëses se të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesë mbrojtësja i të dënuarit thekson se ka ushtruar ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, por gjykata e shkallës së dytë nuk e ka njoftuar për seancën e kolegjit, dhe me këtë i është mohuar e drejta për t'i elaboruar pretendimet në ankesë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se të dënuarit me aktgjykimin e shkallës së parë i është shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje prej ... muaj, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datë 30.03.2023 deri më datë 28.07.2023, si dhe dënim unik me gjobë në shumën prej ... euro, kundër këtij aktgjykimi ankesë ka ushtruar prokurori i shtetit, kurse gjykata e shkallës së dytë e ka mbajtur seancën e kolegjit pa i njoftuar palët për seancë, gjë që vërtetohet nga regjistri i shkresave të lëndës së gjykatës së shkallës së dytë, sepse mungojnë fletë kthesat që do të vërtetonin faktin se mbrojtësja dhe i pandehuri janë njoftuar për seancën e kolegjit.

Duke pasur parasysh këtë gjendje të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së dytë ka shkelur dispozitën e nenit 390 par.1 të KPP. Sipas kësaj dispozite kur të akuzuarit i është shqiptuar dënim me burgim apo kur ka pretendime që shtrohen për shqyrtimin e fakteve dhe ligjit për të bërë vlerësim lidhur me fajësinë apo pafajësinë, njoftimi për seancë të kolegjit i dërgohet Prokurorit të Apelit, të dëmtuarit dhe mbrojtësit të tij apo përfaqësuesit të viktimave, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij.

Meqë, në rastin konkret ndaj të dënuarit është shqiptuar dënim me burgim, konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPP gjykata është e dashur të njoftohet për seancën e kolegjit se bashku me mbrojtësin e tij, shkelje kjo që ka mundur të ndikojë në mos marrjen e një vendimi të ligjshëm dhe të drejtë nga ana e gjykatës së shkallës së dytë, për çka kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë u pranua si e bazuar dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë u anulua, kurse lënda i kthehet gjykatës së shkallës së dytë për rigjykim.

Në rigjykim gjykata e shkallës së dytë obligohet ta mënjanojë shkeljen e lartpërmendur, e pastaj të marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha më lart dhe në kuptim të nenit 438 par.1 nënpar.1.2 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.103/2024, më 12 mars 2024

Procesmbajtësi,  
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,  
Valdete Daka